



Nëntor 2013

Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Bashkangjituni!

Kuvendi Vjetor i RrGGK-së 2013,
7 Dhjetor, 10:30 – 15:15, Sheshi 21

Në këtë numër

Feministet e Reja Bëjnë Strategji dhe Impresionojnë Zyrtarët..... 2

Shtatë Organizata Përfitojnë Grante nga Fondi i Grave të Kosovës..... 3

Forum Teatri Fuqizon Gratë nga Rajoni..... 3

Universiteti Themelon Qendrën për Studime dhe Hulumente Gjimore 4

Ikebana Funkcionon e Pavarur, Prodhon Çaja 4



[Faqja në Facebook](#)



[Lista e dërgesave](#)

RrGGK, AH Publikojnë “Ku Janë Paratë për të Drejtat e Grave?”

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) dhe Alter Habitus – Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë publikuan raportin “Ku Janë Paratë Për Të Drejtat e Grave? Studim Rasti në Kosovë”. Kjo ngjarje bashkoi më shumë se dyzet pjesëmarrës (donator, organizata jo qeveritare të grave dhe pjestarë tjerë të shoqërisë civile) për të diskutuar të gjeturat dhe rekomandimet e hulumtimit 9 mujor.

Në prezentimin e saj, Nicole Farnsworth nga RrGGK theksoi se “organizatat për të drejtat e grave luajnë rol të rëndësishëm në përkrahjen dhe krijimin e institucioneve demokratike, avancimin e të drejtave të grave si të drejta të njeriut, ndryshimin e normave gjimore, ngritjen e vetëdijes publike, ofrimin e shërbimeve për grupet të marginalizuara (veçanërisht kur mungon përkrahja nga shteti), dhe kërkimin e llogaridhënies nga qeveria përmes avokimit.”

Hulumtimi ekzaminon rëndësinë e mbështetjes së organizatave të grave në proceset e ndryshimeve shoqërore; financimit të trendeve mes viteve 2000 dhe 2013; qëndrueshmërisë financiare të vendimeve për financimin (ose mos financimin) e organizatave të grave; dhe mundësitë të bashkëpunimit mes organizatave të grave dhe donatorëve në krijimin e strategjive të përbashkëta për mobilizimin e burimeve dhe mekanizmave të financimit për organizatat e grave. Raporti sjell rekomandime për të gjitha grupet e interesit: për qeverinë, organizatat e grave dhe donatorët, lidhur me mënyrat më të mira për përmirësimin e sigurimit të burimeve të organizatave të grave për të drejtat e njeriut drejt avancimit të barazisë gjimore.

Ishte pajtim unanimit nga të gjithë pjesëmarrësit se një koordinim më i mirë mes donatorëve, organizatave të grave dhe qeverisë, do të ndihmonte në avancimin e të drejtave të grave. Për më tepër, [Fondi i Grave të Kosovës](#) brenda RrGGK-së, i cili kombinon grante të vogla, trajnime intensive dhe mentorim për organizata, u pa si zgjidhje potenciale për donatorët të cilët dëshirojnë t'i përkrahin ato. Derisa organizatat e vogla nuk kanë kapacitetin për të konkurruar me organizata të mëdha, ato bëjnë punë shumë të rëndësishme me grupet rurale dhe ato të marginalizuara.

Gjithashtu, ishte kërkesë e organizatave të grave për kontrata afat-gjatë me donatorët, sepse kjo do të iu mundësonte organizatave të zbatojnë strategji drejt një vizioni afat-gjatë. Për to, përkrahja afat-gjatë, qartazi ndikon në forcimin e lëvizjes së grave në Kosovë dhe avancimin e ndryshimeve shoqërore.

Ky hulumtim, mbështetur nga [Association of Women in Development \(AWID\)](#) dhe [Kvinna till Kvinna](#), është zhvilluar në mes muajit janar dhe shtator 2013. Raporti përfshinë 40 intervista me donatorë të cilët punojnë në Kosovë, dhe pyetësorë me 90 organizata të grave.



María Melbing nga Ambasada Suedeze dhe Arsim Aziri nga Agjencioni Austrian për Zhvillim (ADA) diskutojnë gjetjet e hulumtimit gjatë publikimit.

Feministet e Reja Bëjnë Strategji dhe Impresionojnë Zyrtarët

Me 13-14 nëntor, 40 feministe të reja nga e gjithë Kosova dhe shtetet fqinje të rajonit (p.sh., Serbia, Maqedonia, Kroacia) janë mbledhur të kalojnë dy ditë produktive së bashku. Organizuar nga RrGGK dhe përkrahur nga Kvinna till Kvinna, [Forumi Rajonal i Feministeve të Reja 2013](#) u dha mundësinë vajzave të shprehen për çështjet aktuale vendore dhe globale. Çështja kryesore që u ngrit nga vajzat është: Edukimi.

Vajzat nga Kosova dhe rajoni prezantuan aktivitetet avokuese ku ato janë të përfshira. Ato shkëmbyen informata dhe mësuuan më shumë nga përvojat e njëra tjetrës, si dhe pengesat që janë shfaqur gjatë punës. Më pas ato u ndanë në grupe për të diskutuar mbi çështjet e ngritura në takimet e mbajtura në gjithë Kosovën në vitin 2013 përmes Iniciativës për Fuqizimin e Vajzave (IFV), si dhe mbi strategjitë avokuese, feminizmin, komunikimin dhe përfshirjen e vajzave në procese vendim-marrëse. Në vazhdim, vajzat krijuan strategji avokuese për ditën e nesërme.

Gjatë ditës së dytë, dy grupet të cilat u fokusuan tek nevoja e përfshirjes së psikologëve në shkolla dhe çasjes në arsim [u takuan me zyrtarë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë](#). Zyrtarët shprehën interesimin e tyre dhe u përgjigjën në pyetjet dhe idetë e propozuara.

“Unë u mahnitua nga gatishmëria e zyrtarëve të MASHT, që na dhanë përgjigje në secilën pyetje dhe shumë rekomandime praktike” tha njëra nga feministet e reja. “Takimi zgjati një orë më tepër se që ishte paraparë.”

Grupi tjetër [vizitoi Znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës](#). Ato prezantuan çështjet kryesore të ngritura nga vajzat gjatë Forumit. Presidentja ishte shumë e vëmendshme, përkrahëse dhe e angazhuar në bisedë. Ajo theksoi se vajzat janë e ardhmja e Kosovës, dhe se atyre i duhet përkrahje e vazhdueshme. Pas takimit zyrtar, Presidentja vazhdoi diskutimin me vajzat, duke shkëmbyer ide të ndryshme.

“Presidentja e Kosovës na mirëpriti me ngrohtësi, dhe jo vetëm që shprehi interesim në çdo gjë që ne kishim për të thënë, por vazhdoi takimin edhe për 15 minuta më gjatë,” tha njëra nga feministet e reja. “Të takosh Presidenten nuk është diçka që mund të bëhet çdo ditë, prandaj ishte shumë e veçantë.”

Grupi “Mediat” u fokusua në shkrimin e një artikulli të thjeshtë dhe mënyrën e të folurit para kamerave. Ato gjithashtu diskutuan se si mediat i paraqesin vajzat dhe gratë nëpërmjet gjuhës degraduese dhe raportimit jo-etik.

“Diçka shumë të rëndësishme që kemi mësuar ishte që nëse lexojmë, dëgjojmë apo shohim një lajm të papërshtatshëm ose me paraqitje negative, duhet ta raportojmë tek [Këshilli i Mediave të Shkruara](#) ose [Komisioni i Pavarur për Media](#), varësisht nga lloji i mediave përkatëse,” tha njëra nga feministet e reja.

Ditën e nesërme, tri nga vajzat nga ky grup vunë njohuritë e reja në praktikë, duke u shfaqur në programin e mëngjesit në RTV21 për të prezantuar çështjet e ngritura në Forum.

Përveq këtyre, shtatë vajza nga grupi me fokus tek “Arti dhe Organizimi” përgaditën një Aksion në Rrugë, me përkrahjen e Artpolis. Ky aktivitet kishte për qëllim të paraqiste “Diskriminimin në punë – Ngritjen në pozitë” të të gjitha vajzave dhe grave. Të gjitha pjesëmarrëset u mbledhën para Teatrit Kombëtar për të parë performancën, e cila më pas u shfaq edhe nga shumica e mediave të Kosovës.

“Aktiviteti në rrugë ishte një shembull konkret se çfarë mund të arrish përmes organizimit dhe punës në grupe,” tha njëra nga feministet e reja. “Me të vërtetë ne arritëm ta përçojmë mesazhin tek kalimtarët, gjithashtu nëpërmjet mediave televizive që ishin të pranishme.”

Në fund, pjesëmarrëset e Forumit rishikuan Deklaratën e Forumit, propozuan ndryshime dhe e votuan për aprovim. Deklarata kërkon zbatimin e kuotës 30% në proceset vendim-marrëse; zbatimin e ligjit për arsim parauniversitar; sigurimin e transportit dhe librave për të gjithë

studentët e arsimit të detyruar; përfshirjen e psikologëve në shkolla dhe zbatimin e kodit etik për mediat e shkruara dhe ato elektronike. Deklarata i është dërguar Znj. Atifete Jahjaga, [Presidente e Republikës së Kosovës](#); Z. Hashim Thaçi, [Kryeministër i Republikës së Kosovës](#); [Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë](#); [Ministria e Financave](#); [Agjencia për Barazi Gjinore](#); [Parlamenti i Republikës së Kosovës](#); [Komisioni i Pavarur për Media](#) dhe [Këshilli i Mediave të Shkruara](#).



Pjesëmarrëset e Forumit veshin Majicat me shkrimin, “Kështu duket një feministe” në Forumin Rajonal të Feministeve të Reja 2013, që u mbajt me 13-14 nëntor në Prishtinë.

Shtatë Organizata Përfitojnë Grante nga Fondi i Grave të Kosovës

Me 22 nëntor, shtatë organizata anëtare të RrGGK-së kanë përfitur grante nga [Fondi i Grave të Kosovës](#), me shumë totale prej €18,509. Gjatë sesionit të orientimit, ato nënshruan kontratat dhe me shumë energji u përgaditën të fillojnë iniciativat e tyre. Fondi u mundëson organizatave të vogla që nuk përkrahen, grupeve rurale dhe/ose të marginalizuara të kenë çasje në fonde për iniciativa të rëndësishme në nivel lokal.

“Jam shumë i lumtur që nëpërmjet Rrjetit mund të arrijmë tek organizatat që punojnë me komunitetin, diçka që ne nuk mund ta bëjmë me kapacitetet e brendshme të stafit,” tha Christian Geosits nga [Austrian Development Agency \(ADA\)](#), i cili ka mbështetur raundin e katërt të granteve. “E çmoj strukturën që e kemi krijuar së bashku me Rrjetin sepse funksionon shumë mirë duke pasur çasje tek organizatat që punojnë me komunitetin.” Përfituesit e granteve dhe iniciativat e tyre përfshijnë:

- Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës (OPDMK) do të organizoj aktivitetet e ndryshme për personat me aftësi të veçanta nga Prishtina, Gjilani, Ferizaji, Mitrovica, Prizreni dhe vende të ndryshme rurale. (€2,700)
- Shoqata Iniciativa e Grave do të trajtojë gratë nga fshati Bresanë në Dragash për rrobaqepësi, drejt rritjes së mundësive për punësim. (€3,000)
- Gruaja Bashkëkohore do të organizoj ligjerata mbi shëndetin, trajnime psikologjike dhe ushtrime si zëvendësim i psikoterapisë, dhe gjithashtu do të avokoj për ofrimin e shërbimeve më të mira për personat me nevoja të kufizuara nga spitali rajonal i Prizrenit. (€2,155)
- Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes do të organizoj sesione edukative për të rinjtë në Komunën e Gjakovës mbi temën e “Mbrotjes nga Sëmundjet Seksualisht të Transmetueshme.” (€2,390)
- OJQ Gora do të punojë në fuqizimin ekonomik të grave Gorane në Dragash nëpërmjet punimit të produkteve punëdore dhe shitjes së tyre në panaire. (€2,780)
- Hendifer do të organizoj vizita gjinekologjike dhe trajnime për gratë në fshatra, drejt parandalimit të kancerit në gji dhe mitër. (€2,630)
- Alma do të punoj në identifikimin e grave dhe fuqizimin ekonomik të dy komuniteteve në Komunën e Pejës: Lutogllava and Leshan. (€2,854)

Nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës, organizatave gjithashtu u ofrohet mentorim dhe mbështetje në ngritjen e kapaciteteve të tyre organizative. “E vlerësoj shumë këtë session sepse të gjitha këto informata do të na duhen gjatë zbatimit të projektit,” tha njëra nga përfitueset e grantit.

Gjatë sesionit të orientimit, organizatat mësuuan procedurat e raportit narrativ dhe financiar, si dhe mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit.

“Sot ato morën shumë shembuj dhe këshilla se si ta menaxhojnë si duhet një projekt,” tha Arsim Aziri nga ADA, i cili morri pjesë në takim. “Është shumë punë e madhe për projekte kaq të vogla, por definitivisht ato do të mësojnë nga kjo përvojë.”

Nëpërmjet Fondit, RrGGK u ofron organizatave anëtare aftësi dhe përvoja të reja të cilat u mundësojnë atyre të aplikojnë tek përkrahës të tjerë në të ardhmen.



OPDMK diskutojnë mbi kontratën e tyre me RrGGK-në.

Forum Teatri Fuqizon Gratë nga Rajoni

Me 8-11 nëntor, gratë nga rajoni u mbledhën në qytetin e bukur të Prizrenit, në punëtorinë mbi “Përdorimin e Teatrit si Mjet për Fuqizimin e Grave.” Organizuar nga organizata anëtare e RrGGK-së [Artpolis](#), kjo është punëtorja e parë rajonale e këtij lloji. Trajnimi ka përfshirë Forum Teatrin, një lloj teatri i ri dhe me ndikim që është krijuar për t’i mësuar njerëzit se si të bëjnë ndryshime në rrethin ku jetojnë. Gjithashtu ka përfshirë sesione interaktive në mes të aktorëve dhe audiencës. Në fund të çdo shfaqje, audienca ka mundësi të diskutojë dhe të bëjë sugjerime mbi çështjet e ngritura nga aktorët. Përmes përdorimit të Forum Teatrit, Artpolis ka për qëllim të fuqizojë gratë pjesëmarrëse nga Kosova, Serbia, Mali i Zi, Bosnia dhe Hercegovina dhe Maqedonia. Gjatë kësaj punëtorie tri ditore, pjesëmarrëset mësuuan mbi Forum Teatrin. Të ndara në grupe të vogla, ato krijuan shfaqje Forum Teatër me tema të ndryshme. Më pas kjo u përcjell me debate, gjatë të cilave pjesëmarrëset e tjera shkëmbyen ide dhe përvoja. “Unë kalova një kohë shumë të mirë,” tha Nadja Duhacek nga Gratë Në të Zeza në Serbi. “Ne patëm rastin të shkëmbejmë përvoja me njëra tjetrën. Kam takuar shoqe të vjetra dhe kam krijuar miqësi të reja. Aktiviteti gjithashtu ka qenë shumë praktik dhe fuqizues.”

Mbrëmjeve, pjesëmarrëset bënë shetitje nëpër qytetin historik të Prizrenit dhe festuan gjatë një ndeje në mbrëmjen e tretë të trajnimit. Punëtorja është mbështetur nga [Kvinna till Kvinna](#). “Ishte një përvojë shumë e mirë dhe kemi kaluar jashtëzakonisht mirë së bashku,” tha njëra nga pjesëmarrëset.

Universiteti Themelon Qendrën për Studime dhe Hulumtime Gjinore

Me 24 nëntor, Instituti për Studime Sociale dhe Humanistike (ESSI) i Universitetit të Prishtinës dhe Instituti për Hulumtime Gjinore në Dartmouth (GRID) lancuan së bashku Qendrën për Studime dhe Hulumtime Gjinore (QSHGJ) në ESSI.

Fillimisht në këtë ditë, ESSI dhe GRID organizuan

një punëtori, e cila rezultoi nga bashkëpunimi një vjeçar mes ESSI dhe Kolegji Dartmouth. Punëtorja mbledhi përfaqësues të shoqërisë civile, institucionet e Kosovës, agjencione kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe staf akademik për identifikimin e objektivave të kësaj iniciative.

Qëllimi i Qendrës është të ofrojë një strukturë kombëtare të bursave dhe analizave të cilat do të ndihmonin liderët në Kosovë dhe Ballkan pasi që ata implementojnë politika që mbështesin barazinë gjinore. Qendra gjithashtu do të shërbejë si forum për ngjarje dhe programe të dizajnuara që të ngrisin aftësitë dhe të përgadisnin gratë për role udhëheqëse. Nevoja për një Qendër të tillë është artikuluar nga studiues në rajon. Iniciativa për themelimin e Qendrës filloi si rezultat i Samitit Ndërkombëtarë të Gruas dhe rezultatet e saj "Prishtina Principles".

"Kjo iniciativë reflekton mbi përgjegjësitë të cilat i kemi dhe duhet t'i marrim mbi vete në mënyrë që të avancojmë pozitën e grave në shoqërinë tonë, edhe si udhëheqës të institucioneve publike politike apo akademike, anëtarë të sektorëve privat apo të shoqërisë civile, dhe si qytetarë të zakonshëm," tha Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, gjatë fjalimit të saj në ceremoninë e hapjes së Qendrës.

Kjo Qendër adreson problemet e lartpërmendura nëpërmjet hulumtimit dhe analizave që mund të përdoren për informimin e politikave dhe krijimin e pjesës qëndrore të bursave të cilat do t'i shërbejnë kombit dhe rajonit të ecin përpara. Qendra gjithashtu do të ofrojë një forum ku studiuesit mund të shkëmbejnë ide dhe të bëhen partnerë me agjencione qeveritare në mënyrë që të çojnë këto ide direkt në aksion.

Ikebana Funkcionon e Pavarur, Prodhon Çaja

Një grup i grave ndëretnik në Shtërpce gjithmonë ka ëndërruar të formojë organizatën nëpërmjet së cilës ato do të mund të mbledhnin dhe shesnin në treg çaja bimor. Qëllimi i tyre ishte të përgadisnin produkte me përbërës kualitativ që janë në dobi të ambientit. Disa nga bimët medicinale me të cilat ato donin të punonin, janë shumë të njohura në industrinë farmaceutike. Me përkrahjen e Fondit të Grave ato e kanë të mundur të plotësojnë ëndërrën e tyre, duke hapur organizatën "Ikebana." Sidoqoftë, themelimi i një organizate të re nuk është një detyrë e lehtë. Anëtarët e Ikebanës kishin nevojë për përkrahje në krijimin e sistemit, politikave dhe procedurave që organizata e tyre të funksionojë e pavarur. Anëtarët e stafit të RrGGK-së ofruan

mentorim për të përkrahur ato në zhvillimin e tyre. Me përkrahjen e RrGGK-së, ato gjithashtu kanë blerë makina për tharjen dhe prodhimin e çajit. Ato filluan punën duke mësuar nga njëra tjetra. Gjithashtu, morrën pjesë në trajnime, kështu duke ju mundësuar përfitimin e informatave teorike dhe praktike. Ato përdorën njohuritë e tyre për fillimin e mbledhjes dhe prodhimit të çajrave në muajin qershor. Edhe pse filluan si një grup i vogël, me kalimin e kohës grupi i tyre është rritur. "Ne tërë kohën ishim duke kërkuar një mënyrë për të filluar punën, që të tregojmë se mund të punojmë," tha Ankica Zivkovic, Drejtore Ekzekutive e Ikebanës. "Tani, me fonde nga RrGGK, ne po e tregojmë potencialin tonë. Ne i falënderohemi Fondit të Grave të Kosovës për këtë mundësi."



Gratë anëtare të Ikebanës në Shtërpce thajnë çaja me përkrahjen nga Fondi i Grave të Kosovës, RrGGK.